



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 6, datë 29.03.2019**

**MBI**

**“MIRATIM PËR PËRJASHTIM/REDUKTIM, NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTËT TË CIKLIT TË PARË/TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, date 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”; urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 51, datë 03.12.2018 mbi “Ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen/reduktohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019, në Universitetin e Arteve”(i ndryshuar), Bordi i Administrimit pasi diskutoi rreth **Relacionit**, paraqitur nga Administrator i UART znj. Alma Sinanaj dhe duke u bazuar ne aktet e dala për këtë qëllim, të shqyrtuara e të paraqitura nga Grupi i Punës dhe pasi e diskutoi,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin për përjashtimin dhe reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve të Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2018-2019, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur vendimit.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakultetet e Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**




**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**


**Prof. Besnik Bisha (Kryetar)**

  
\_\_\_\_\_

**Prof. Arben BASHA (Anëtar)**

  
\_\_\_\_\_


**Prof. Artan Peqini (Anëtar)**

  
\_\_\_\_\_

**Lorenc Vangjeli (Anëtar)**

  
\_\_\_\_\_


**Risena Xhaja (Anëtar)**

  
\_\_\_\_\_

**Aida Martiro (Anëtar) (fotokopim)**

  
\_\_\_\_\_

**Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)**

  
\_\_\_\_\_

